



2024

# BULETINI

---

## DHJETOR



## **KKSB i bashkohet fushatës 16 Ditë të Aktivizimit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore**

*Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), i kryesuar nga Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, mbajti takim të pestë për këtë vit.*

*Gjatë kësaj mbledhjeje, anëtarët e KKSB-së u fokusuan në diskutimin e çështjeve që lidhen me sigurinë dhe mirëqenien e qytetarëve, duke i dhënë përparësi fushatës “16 Ditë të Aktivizimit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore”. Ata theksuan rëndësinë e parandalimit të dhunës me bazë gjinore, duke bërë thirrje për ndërgjegjësim më të madh, mbështetje për viktimat dhe bashkëpunim të ngushtë ndërmjet institucioneve.*

*Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, theksoi përkushtimin e tij dhe të institucioneve komunale për të adresuar dhunën dhe për të mbështetur iniciativat që kanë për qëllim sensibilizimin kundër dhunës me bazë gjinore.*

*“Është detyra jonë si udhëheqës lokalë të sigurojmë që çdo qytetar të ndihet i mbrojtur dhe i respektuar. Komuna e Lipjanit do të vazhdojë të mbështesë çdo nismë që promovon drejtësi dhe barazi dhe do të angazhohet për krijimin e një mjedisit ku çdo individ ka mundësi të jetojë i sigurt dhe me dinjitet,” tha kryetari Ahmeti.*

*Nënkryetari z. Diamant Bytyqi vuri në pah rëndësinë e angazhimit të institucioneve dhe komunitetit në trajtimin e dhunës me bazë gjinore.*

*“Dhuna me bazë gjinore vazhdon të jetë një sfidë serioze dhe shqetësuese për shoqërinë tonë. Është e domosdoshme të angazhohemi së bashku, sepse vetëm përmes përkushtimit të institucioneve dhe qytetarëve mund të ndërtojmë një mjedis më të sigurt dhe më të drejtë për të gjithë,” tha nënkryetari Bytyqi.*

*Në takim mori pjesë gjithashtu znj. Jennifer Ober, Shefe e Zyrës së Aktivitetit të Qeverisjes së Pronës të USAID-it, e cila përgëzoi angazhimin e Komunës së Lipjanit për këtë iniciativë të rëndësishme, e cila ka si fokus diskutimin dhe mbështetjen e fushatës kundër dhunës me bazë gjinore.*



**Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, ka pritur në takim përfaqësueset e Organizatës për Fëmijët pa Përkujdesje Prindërore (OFAP), ku u diskutua mbi sfidat që përballen fëmijët pa përkujdesje prindërore dhe familjet strehuese që kujdesen për ta. Gjatë takimit u theksua rëndësia e mbështetjes së qëndrueshme për këto kategori.**

**Kryetari Ahmeti deklaroi se familjet strehuese në Komunën e Lipjanit do të mbështeten përmes subvencioneve, duke shprehur përkushtimin e tij për t'i fuqizuar ato.**

**“Familjet strehuese janë shtylla kryesore e mbështetjes për fëmijët që kanë më së shumti nevojë për dashuri dhe përkujdesje. Si komunë, jemi të përkushtuar të mbështesim këto familje dhe t'i fuqizojmë për të vazhduar punën e tyre të mrekullueshme”, tha kryetari Ahmeti.**

**Përfaqësueset e OFAP shprehën mirënjohje ndaj kryetarit Ahmeti për angazhimin dhe gatishmërinë e tij për të ndihmuar fëmijët pa përkujdesje prindërore dhe familjet strehuese, duke vlerësuar qasjen e tij proaktive.**



## ***Kryetari Ahmeti merr pjesë në shënimin e Ditës Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara, organizuar nga Freesia Paper Factory***

*Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara, kompania Freesia Paper Factory organizoi një ekspozitë unike me piktura të realizuara nga persona me aftësi të kufizuara. Kjo ekspozitë shfaq talentin dhe kreativitetin e jashtëzakonshëm të autorëve, duke përcjellë një mesazh frymëzues për të gjithë shoqërinë.*

*Gjatë kësaj ngjarjeje, kryetari Ahmeti përshëndeti organizatorët dhe theksoi rëndësinë e aktiviteteve të tilla në promovimin e përfshirjes dhe mbështetjes për personat me aftësi të kufizuara.*

*“Kompania Freesia është një shembull i shkëlqyer për krijimin e mundësive të punësimit për personat me aftësi të kufizuara. Shpresojmë që shembullin e kësaj kompanie ta ndjekin edhe kompanitë tjera, duke kontribuar në krijimin e më shumë mundësive për këtë kategori,” tha kryetari Ahmeti.*

*Në përfundim të ngjarjes, përfaqësuesit e Freesia Paper Factory ftuan kryetarin Ahmeti që të ndante çmimet për pjesëmarrësit, duke i dhënë ngjarjes një vlerë të veçantë për të gjithë të pranishmit.*



***Nënkryetari i Komunës së Lipjanit z. Diamant Bytyqi, ka marrë pjesë në aktivitetin e organizuara nga shoqatat Handakos dhe Organizata Multietnike e Personave me Aftësi të Kufizuara, ku me këtë rast kanë shënuar Ditën Botërore të Personave me Aftësi të Kufizuara.***

***Gjatë këtij takimi u tha se me organizimin e këtyre aktiviteteve është një mundësi e mirë për vazhdimin e ndërgjegjësimit tonë si shoqëri, për eliminimin e të gjitha paragjytimeve dhe krijimin e një ambienti që do të ofronte kushtet për një jetë sa më të lumtur dhe mirëqenie për këtë kategori të çmuar të shoqërisë sonë.***



**Këshilli Komunal për Mbrojtjen e Viktimave të Dhunës në Familje dhe në Baza Gjimore në Komunën e Lipjanit i formuar me vendim të Kryetarit të Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, po vazhdon me aktivitetet edhe gjatë ditës së sotme në kuadër të aktivizimit 16-ditor kundër dhunës në familje dhe në baza gjimore.**

**Këto aktivitete po realizohen me qëllim të ndërgjegjësimit dhe vetëdijesimit të qytetarëve se dhuna ndaj gruas dhe familjes është akt që shkel të drejtat e njeriut. Kjo fushatë do të vazhdojë deri më 10 dhjetor, njëherit do të bëhet edhe promovimi i të drejtave dhe barazisë gjimore.**



## ***Komuna e Lipjanit në bashkëpunim me organizatat Islamic Relief Kosova shpërndan motokultivatorë për bujqit e Lipjanit***

*Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, ka marrë pjesë në shpërndarjen e motokultivatorëve për bujqit lipjanas. Gjatë këtij aktiviteti, ai uroi përfituesit dhe theksoi angazhimin e komunës për përmirësimin e kushteve të punës dhe për nxitjen e zhvillimit ekonomik të sektorit bujqësor.*

*“Sektori i bujqësisë është një nga prioritetet tona kryesore, pasi ndikon drejtpërdrejt në mirëqenien e qytetarëve tanë. Shpresoj që këto pajisje të kontribuojnë në përmirësimin e kushteve të punës për të gjithë fermerët. Angazhimi ynë për bujqësinë do të vazhdojë, dhe jemi të përkushtuar të mbështesim fermerët me pajisje bujqësore moderne për të lehtësuar punën dhe për të nxitur rritjen e këtij sektori,” tha kryetari Ahmeti.*

*Përfaqësuesja e Islamic Relief Kosova vlerësoi bashkëpunimin e ngushtë me Komunën e Lipjanit, duke theksuar se ky projekt është vetëm një nga shumë projektet që po realizohen në fushën e bujqësisë, të cilat synojnë mbështetje në zhvillimin e sektorit të bujqësisë.*

*Fermerët përfitues shprehën mirënjohje për ndihmën e ofruar, duke e konsideruar këtë mbështetje të rëndësishme për përmirësimin e kushteve të punës së përditshme në bujqësi.*



***Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, ka takuar përfaqësuesit e klubit Oldtimer Prishtina, të cilët i ka falënderuar për organizimin e parakalimit të veturave klasike në sheshin “Adem Jashari” në qytetin e Lipjanit.***

***Ndërsa, përfaqësuesit e klubit Oldtimer Prishtina i kanë ndarë Kryetarit Ahmeti mirënjohje për mbështetjen në realizimin e aktivitetit të organizuar në kuadër të 28 nëntorit.***



**Këshilli Komunal për Mbrojtjen e Viktimave të Dhunës në Familje dhe në Baza Gjimore në Komunën e Lipjanit i formuar me vendim të Kryetarit të Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, ka vazhduar edhe me aktivitetet në kuadër të aktivizimit 16-ditor kundër dhunës në familje dhe në baza gjimore dhe me theks të veçantë për femicidin.**

**Ne këtë 16 ditë të aktivizimit janë zhvilluar shumë aktivitete me qëllim të ndërgjegjësimit dhe vetëdijësimit të qytetarëve se dhuna ndaj gruas dhe familjes është akt që shkel të drejtat e njeriut, në shkollat e mesme, filllore, Qendrën korrektuese edukuese për të mitur, qendrën korrektuese për gra, bashkësinë islame si dhe një numër të konsideruar të grave nëpër lokalitete.**

**Te gjitha këto aktivitete u mbështeten nga Kryetari i Komunës Imri Ahmeti, institucionet gjegjëse, përfaqësuesit nga Këshilli Komunal për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Baza Gjimore, Qendra për Pune Sociale, Zyra për Barazi Gjimore, prokuroria gjykata policia- njësia e hetimeve, Drejtoria Komunale e Arsimit, ajo e Kulturës Rinisë dhe Sportit, përfshirë drejtoret e shkollave, Bashkësia Islame departamenti i gruas si dhe në pjesën logjistike nga OSBE.**

**Kjo fushatë ka filluar me 26 nëntor dhe ka vazhduar deri më sot 10 dhjetor, njëherit kishte për qëllim edhe promovimin e të drejtave dhe barazisë gjimore.**

ruar që zëri i qytetarëve të jetë  
i përfqësuar në punën tonë.

me zastupljen u našem radu.

Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun Svizra



**Komuna e Lipjanit ka pranuar mirënjohje nga Projekti për Decentralizim dhe Përkrahje të Komunave (DEMOS), i financuar nga Bashkimi Evropian, Zvicra dhe Suedia, dhe i zbatuar nga Helvetas Swiss Intercooperation, në bashkëpunim me Ministrinë e Administratës së Pushtetit Lokal, për bashkëpunimin e saj në implementimin e Auditimit Social, një mjet i rëndësishëm për sigurimin e përfshirjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes, si dhe përkushtimin ndaj rritjes së transparencës dhe llogaridhënies në zbatimin e investimeve publike.**

Me këtë rast, Nënkryetari i Komunës së Lipjanit, z. Diamant Bytyqi, duke pranuar mirënjohjen ka falënderuar projektin (DEMO) ku edhe theksoi që ky projekt do të vazhdojë të zbatohet në Komunën e Lipjanit.

Gjithashtu, mirënjohje nga "Auditimi Social - Qytetarët që bëjnë ndryshimin" u është dorëzuar edhe dy qytetarëve vullnetarë të angazhuar në këtë projekt, Ganimete Osmani dhe Kamer Podrimqaku, për kontributin e tyre aktiv në procesin e auditimit social në Komunën e Lipjanit.

Në vitin 2024, Projekti DEMOS, në bashkëpunim me Ministrinë e Administratës së Pushtetit Lokal dhe me mbështetje nga organizatat e shoqërisë civile si BIRN, D+, KLGJ dhe partnerët lokalë, ka mbështetur themelimin e ekipeve të Auditimit Social në 12 komuna, me pjesëmarrjen e rreth 250 qytetarëve.



**Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, së bashku me bashkëpunëtorët e tij, ka pritur në takim delegacionin e Ambasadës së Francës në Kosovë të udhëhequr nga z. Frederic Deshayes.**

**Gjatë takimit, u diskutua mbi bashkëpunimin ndërmjet Komunës së Lipjanit dhe Komunave Franceze, si dhe promovimin e mësimi të gjuhës frënge në shkollat e mesme të komunës.**

Kryetari Ahmeti shprehu mirënjohjen për vizitën, duke falënderuar Ambasadën Franceze për mbështetjen që shteti francez i ka dhënë Kosovës, veçanërisht në forcimin e shtetësisë dhe zhvillimin e arsimit, ndërsa theksoi rëndësinë e mësimi të gjuhës frënge në shkollat e Lipjanit.

“Në shkollat tona nxënësit kanë zgjedhur gjuhën frënge si lëndë për të mësuar dhe kjo dëshmon interesin dhe vullnetin për të njohur më mirë kulturën dhe gjuhën franceze. Për këtë arsye, kërkoj mbështetjen e Ambasadës Franceze për të promovuar më tej këtë lëndë dhe për të zgjeruar shtrirjen e saj,” tha kryetari z. Ahmeti. Ai shtoi gjithashtu se komuna është e gatshme për bashkëpunime të mëtejshme me Komunat Franceze për realizimin e aktiviteteve të përbashkëta kulturore.

Nga ana tjetër, z. Frederic Deshayes falënderoi kryetarin Ahmeti për mikpritjen dhe përkushtimin ndaj promovimit të kulturës franceze, duke theksuar rëndësinë e forcimit të marrëdhënieve mes Francës dhe Kosovës.



**Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, ka marrë pjesë në ceremoninë e organizuar nga USAID, e cila kishte për qëllim zgjerimin e partneriteteve për qeverisje të përgjegjshme dhe transparente.**

**Kryetari Ahmeti, gjatë fjalimit të tij, theksoi rëndësinë e partneritetit dyvjeçar ndërmjet Komunës së Lipjanit dhe USAID-it, në kuadër të Programit të Integritetit të Komunave të Kosovës, duke reflektuar mbi sukseset e arritura gjatë kësaj periudhe.**

**“Ky bashkëpunim ka sjellë një transformim të qëndrueshëm në qeverisjen lokale, duke forcuar transparencën, llogaridhënien dhe efikasitetin e institucioneve komunale. Përvoja jonë me këtë projekt na ka mësuar rëndësinë e investimit në burimet njerëzore dhe krijimin e proceseve të bazuara në integritet dhe transparencë”, tha Kryetari Ahmeti. Ai vlerësoi arritjet kryesore të këtij bashkëpunimi, duke përfshirë përmirësimin e shpenzimeve buxhetore, publikimin e mbi 90% të dokumenteve të prokurimit publik dhe organizimin e trajnimeve për më shumë se 139 zyrtarë komunalë.**

**Në fund të fjalimit, Kryetari Ahmeti shprehu mirënjohje të sinqertë ndaj USAID-it për mbështetjen e dhënë dhe theksoi rëndësinë e vazhdim të këtij partneriteti për të arritur rezultate të jashtëzakonshme në të ardhmen.**



**Me iniciativën e grupit parlamentar të LDK-së, në Kuvendin Komunal të Lipjanit u mbajt seancë e jashtëzakonshme për të kundërshtuar vendimin e Qeverisë së Kosovës lidhur me ndërtimin e një deponie sanitare të re në territorin e Komunës së Lipjanit, konkretisht në zonën kadastrale në Poturovc, Ribar i Madh dhe Qylagë.**

Armend Grajqevci, iniciues i seancës, theksoi se për banorët e kësaj zone, vendosja e deponisë në mes të fshatrave është e papranueshme dhe e dëmshme, pasi do të ketë ndikime negative në jetën e qytetarëve të fshatrave përreth kësaj deponie. Ai kërkoi nga asamblistët që të reagojnë si Kuvend dhe të kundërshtojnë ndërtimin e kësaj deponie. Grajqevci theksoi se Qeveria, në vend të investimeve në projekte, nuk duhet të na dhurojë deponi mbeturinash.

Gjatë kësaj seance, në fjalën e tij, kryetari Ahmeti theksoi qartë qëndrimin e tij, se ndërtimi i kësaj deponie të re sanitare bie ndesh me interesat zhvillimore të kësaj zone.

"Përdërisa unë të jem kryetar i kësaj komune, nuk do të pranoj kurrë që të ndërtohet një deponi e tillë. Me përgjegjësitë që na jep ligji, nuk e pranojmë këtë projekt për shumë arsye. Synimi ynë është që në atë zonë të krijohet një hapësirë e biznesit për zhvillimin afatgjatë. Prandaj, vendosja e një deponie sanitare në kufijtë kadastrale të kësaj zone është dëshmi e mungesës së një vizioni të qartë të qeverisë për zhvillimin e Komunës tonë", – tha kryetari Ahmeti.

Ai po ashtu tha se ky vendim i Qeverisë për ndërtimin e deponisë sanitare në mes të fshatrave do të ndikojë negativisht në jetën dhe mirëqenien e fshatrave në atë rajon. Pa asnjë konsultim me banorët as me zyrtarët e Komunës, dhe në kundërshtim me Planin Hapësinor të Kosovës, ky vendim është tërësisht i papranueshëm dhe kundërligjor.

"Në vend që për këtë temë të ngrejë zërin deputetët dhe përfaqësuesit e Komunës sonë në pushtetin aktual në nivel qendror, ata sjellin këtë dhuratë 'mbeturina' për qytetarët tanë, në vend të projekteve zhvillimore", – shtoi kryetari Ahmeti.

Kryetari Ahmeti apeloi për unitet të plotë në qëndrimet kundërshtuese ndaj këtij projekti dhe kërkoi që si kuvend, si ekzekutiv dhe si qytetarë, të përdorim çdo mjet dhe kompetencë ligjore për të reaguar.

"E ardhmja e atij rajoni varet nga ky vendim i qeverisë. Ne duhet të reagojmë ashpër dhe me forcë të plotë për të pamundësuar realizimin e këtij projekti, i cili do të vështirësonte jetën e qytetarëve në atë zonë dhe do të ndikonte negativisht në gjithë Komunën e Lipjanit. Është detyrë e të gjithëve, pa dallime politike, të mbrojmë interesin e përbashkët", – theksoi kryetari Ahmeti.

Përfundimisht, kuvendi i Komunës së Lipjanit ka vendosur të qëndrojë i vendosur kundër ndërtimit të kësaj deponie, duke theksuar rëndësinë e mbrojtjes së zhvillimit afatgjatë të komunës dhe jetës së qytetarëve të saj.

Gjatë kësaj seance, të gjithë asamblistët e pranishëm miratuan propozimin për kundërshtimin e këtij vendimi me 23 vota pro.



## ***Komuna e Lipjanit nderohet me çmim nga Këshilli i Evropës për bashkëpunimin në programin ROMACTED***

*Komuna e Lipjanit ka marrë një çmim të rëndësishëm për bashkëpunimin e saj me Këshillin e Evropës, në kuadër të programit ROMACTED, i cili synon fuqizimin e komuniteteve rom dhe ashkali në nivel lokal.*

*Në konferencën përmbyllëse të programit ROMACTED, mbajtur në Stamboll të Turqisë, nënkryetari i Komunës së Lipjanit për Komunitete, z. Lulzim Qerimi, prezantoi angazhimet dhe projektet 6-vjeçare të realizuara në Lipjan. Ai theksoi rëndësinë e qeverisjes së drejtë dhe gjithëpërfshirëse për të siguruar trajtim të barabartë për të gjithë qytetarët, pavarësisht përkatësisë së tyre etnike apo sociale.*

*Komuna e Lipjanit u vlerësua si model për mënyrën sesi bashkëpunimi mes grupeve komunitare dhe institucioneve publike ka sjellë rezultate konkrete në përmirësimin e jetës së qytetarëve në lokalitetet ku jetojnë komunitetet rom dhe ashkali.*

*Ky çmim përbën një hap të rëndësishëm drejt ndërtimit të një shoqërie më gjithëpërfshirëse dhe të barabartë në komunën e Lipjanit.*



## **Komuna e Lipjanit për 10 vite ndër komunat më të vlerësuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit**

Zyra Kombëtare e Auditimit, e udhëhequr nga znj. Vlora Spanca, organizoi një takim me temën “Ndikimi i auditimit në përmirësimin e qeverisjes lokale dhe transparencës”, ku mori pjesë edhe kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti.

Gjatë fjalës së tij, kryetari Ahmeti theksoi rëndësinë e gjetjeve dhe rekomandimeve të auditorit të jashtëm, duke vënë në pah se ato ndikojnë drejtpërdrejt në rritjen e standardeve dhe përmbushjen e kërkesave ligjore për një qeverisje më të përgjegjshme dhe transparente. Ai gjithashtu nënvizoi se Lipjani për 10 vjet rresht është ndër komunat kampion në vlerësimin nga Zyra Kombëtare e Auditimit të Përgjithshëm, duke u vlerësuar me opinionin e pakualifikuar si vlerësim më i lartë që dëshmon performancën e shkëlqyer të komunës.

“Jemi krenarë për punën e mirë që është vlerësuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit dhe mbetemi të përkushtuar për të avancuar më tej transparencën dhe llogaridhënien”, ka thënë kryetari Ahmeti.

Kryetari Ahmeti shprehu mirënjohjen ndaj shërbyesve civilë dhe menaxhmentit të komunës për angazhimin e tyre të vazhdueshëm, si dhe ndaj partnerëve ndërkombëtarë, si USAID dhe DEMOS, të cilët kanë dhënë mbështetje për përmirësimin e menaxhimit transparent dhe llogaridhënës. Ai shtoi se ky përkushtim është reflektuar në raportet përfundimtare të auditimit, duke e bërë Lipjanin një model të qeverisjes së mirë.



## ***Homazhe në nderim të katër dëshmorëve të fshatit Krojmir***

***Në shenjë nderimi të 26-vjetorit të rënies së katër dëshmorëve të fshatit Krojmir, kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, së bashku me bashkëpunëtorët e tij, sot ka bërë homazhe dhe ka vënë kurorë lulesh pranë pllakës përkujtimore dhe kompleksit memorial “Katër dëshmorët” në fshatin Krojmir. Kryetari Ahmeti theksoi se kujtimi për dëshmorët është gjithnjë një udhërrëfyes i rëndësishëm në përpjekjet për liri dhe drejtësi. Ai shtoi se sakrifica e tyre na obligon të punojmë me përkushtim për të ndërtuar një të ardhme më të mirë për brezat e ardhshëm.***



***Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, së bashku me bashkëpunëtorët e tij, me rastin e 24-vjetorit të ndarjes nga jeta të Komandantit të UÇK-së, Lulzim Morina (Komandant Luli), nga Brigada "135 Agim Zeneli", ka bërë homazhe dhe ka vendosur kurorë lulesh pranë lapidarit të tij në fshatin Hallaq i Vogël, në nderim të jetës dhe veprës së tij.***

***Gjatë ceremonisë, kryetari Ahmeti theksoi se është detyrë dhe nderim i përhershëm të kujtojmë dhe respektojmë heronjtë si Komandant Luli, të cilët sakrifkuan gjithçka për lirinë që gëzojmë sot. Ai shtoi se jeta dhe vepra e tij do të mbeten gjithmonë burim frymëzimi për brezat e tashëm dhe ata që do të vijnë.***



***Komiteti për Komunitete ka zhvilluar punimet e mbledhjes së 33-të me radhë***

***Në sallën e takimeve të Komunës së Lipjanit, u mbajt mbledhja e 33-të e Komitetit për Komunitete (KK), e udhëhequr nga kryesuesi, z. Skender Bikliqi, ku u shqyrtuan të gjitha pikat e rendit të ditës. Gjatë këtij takimi, përfaqësuesit e Zyrës Lokale për Komunitete informuan anëtarët e KK-së lidhur me punët dhe aktivitetet e këtij sektori, si dhe u miratua plani i punës i Komitetit për Komunitete për vitin 2025.***

***Në përfundim të mbledhjes, anëtarët e Komitetit shqyrtuan disa çështje të ndryshme që prekin jetën e qytetarëve të Komunës së Lipjanit.***



### ***KPF zhvilloi punimet e mbledhjes së 32-të me radhë***

***Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF), udhëhequr nga Kryesuesi i Kuvendit z. Daut Azemi, sot ka mbajtur mbledhjen e 32-të me radhë, ku janë diskutuar të gjitha pikat e rendit të ditës të parapara për këtë mbledhje.***

***Në fillim të këtij takimi, u prezantuan edhe dy pika shtesë për diskutim në këtë mbledhje.***

***Ndërsa, anëtarët e KPF-së pas diskutimeve të bëra gjatë këtij takimi aprovuan dhe rekomanduan të gjitha pikat për mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet të enjten, më 26 dhjetor 2024.***



## ***U mbajt mbledhja e 37-të me radhë e Kuvendit të Komunës së Lipjanit***

***Kuvendi i Komunës së Lipjanit, udhëhequr nga Kryesuesi, z. Daut Azemi, zhvilloi punimet e mbledhjes së 37-të me radhë, ku u shqyrtuan dhe u miratuan të gjitha pikat e rendit të ditës dhe dy pika të tjera shtesë, të propozuara për këtë seancë.***

***Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, së bashku me Nënkryetarin, z. Diamant Bytyqi, gjatë kësaj seance kanë dhënë sqarime për të gjitha pyetjet dhe çështjet e ngritura nga anëtarët e Kuvendit të Komunës.***

***Në fillim të kësaj seance u prezantua një informatë nga Këshilli Komunal Koordinues në mbrojtje të viktimave të dhunës në baza gjinore.***



## Përrurimi i nënkalimit dhe parkingut nëntokësor

Sot jam i lumtur të ndaj me ju momentin e inaugurimit të nënkalimit dhe parkingut nëntokësor, një investim madhor dhe plotësisht i financuar nga buxheti i Komunës sonë. Ky projekt shënon një hap të rëndësishëm drejt modernizimit të Lipjanit, duke lehtësuar qarkullimin e trafikut dhe duke ofruar hapësira të nevojshme për parkim. Projekti përfshin ndërtimin e nënkalimit dhe një parkingu nëntokësor me kapacitet prej 215 vendparkimesh. Punimet do të vazhdojnë për instalimin e kamerave të sigurisë, sistemit të ventilimit, ashensorëve, portave hyrëse-dalëse, shkallëve dhe detajeve të tjera teknike.

Sot, megjithatë, kemi vendosur ta lëshojmë në funksion këtë hapësirë për të përbushur nevojat e qytetarëve tanë sa më shpejt.

Madhështia e këtij projekti do të shfaqet plotësisht pas përfundimit të tij, me ndërtimin e sheshit dhe parkut qendror mbi parkingun. Ky park i gjelbër do të transformojë qendrën e qytetit me hapësira moderne dhe të denja për komunitetin tonë.

Në këtë mënyrë, ky projekt integron nënkalimin, sheshin, parkingun dhe parkun, duke krijuar një zonë atraktive dhe funksionale për të gjithë.

Ky projekt nuk ka qenë i lehtë. Përgesat, përfshirë mosdhënien e pëlqimeve nga ministria përkatëse, kanë ndikuar në zvogëlimin e përmasave të projektit, edhe pse prona është e Komunës dhe e qytetarëve të Lipjanit.

Projekti është financuar vetëm nga mjetet e Komunës sonë, pa asnjë lloj ndihme nga Qeveria, përkatësisht ministritë relevante.

Kostojat e gjithë projektit, pas përfundimit edhe të sheshit dhe parkut, ka vlerën rreth 6,100,000 euro.

Por, pavarësisht sfidave, ne nuk jemi ndalur dhe nuk do të ndalemi. Me përkushtim dhe punë, do të vazhdojmë ta shndërrojmë Lipjanin në një qytet modern, atraktiv dhe të përshatshëm për të gjithë qytetarët.

Urime për këtë arritje të përbashkët!

Me respekt,

I.A



### ***Mbahet takimi i gjashtë i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB)***

*Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), i kryesuar nga Nënkryetari i Komunës së Lipjanit, z. Diamant Bytyqi, mbajti takimin e gjashtë të rregullt për këtë vit. Gjatë takimit, u diskutua gjendja e sigurisë dhe çështje të tjera me rëndësi për territorin e Komunës së Lipjanit.*

*Në hapje të takimit, Nënkryetari z. Bytyqi informoi anëtarët e KKSB-së për zhvillimet më të fundit, duke theksuar përrurimin e projektit më madhor të këtij viti – ndërtimin e nënkalimit dhe parkingut nëntokësor. Ky projekt, me vlerë mbi 6 milionë euro, u realizua brenda 14 muajve dhe u financua tërësisht nga të hyrat vetanake të Komunës së Lipjanit.*

*“Siç keni mundur ta shihni mbrëmë, kemi përruruar nënkalimin dhe parkingun nëntokësor, i cili është një nga projektet më madhore të realizuara ndonjëherë në komunën tonë. Ky projekt jo vetëm që u finalizua brenda një periudhe të shkurtër kohore prej 14 muajsh, por gjithashtu përfaqëson një investim historik të financuar plotësisht nga buxheti komunal,” tha z. Bytyqi.*



## **Kryetari Ahmeti mbajti takim publik me qytetarët**

Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, në sallën e Kuvendit Komunal, në përmbyllje të vitit 2024, mbajti një takim publik me qytetarët, të cilët i njoftoi për punët e realizuara, sfidat dhe të arriturat e komunës gjatë këtij viti që po e lëmë pas.

Kryetari Ahmeti shprehu kënaqësinë për investimet e realizuara gjatë vitit, të cilat kanë ndikuar drejtpërdrejt në përmirësimin e jetës së qytetarëve të Komunës së Lipjanit. Ai cilësoi vitin 2024 si një vit shumë të suksesshëm, duke ia atribuar këtë sukses qytetarëve të Lipjanit.

Në këtë takim, Kryetari Ahmeti veçoi disa nga projektet kryesore, duke përmendur ndërtimin e nënkalimit dhe parkingut nëntokësor, asfaltimin e mbi 62 kilometra rrugë, ndërtimin e 9 kilometra trotuare, shenjëzimin dhe ndriçimin publik. Në sektorin e shëndetësisë, po ndërtohet qendra urgjente në qytetin e Lipjanit dhe Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF). Në arsim, janë realizuar renovime efikase të shkollave në disa vendbanime, ndërsa mbi 800 fermerë kanë përfituar mbështetje. Në fushën e sportit dhe kulturës, janë alokuar mbi 205 mijë euro.



## **Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, ka organizuar ceremoninë solemne, tashmë tradicionale, për mbylljen e vitit 2024**

Gjatë kësaj ceremonie, Kryetari Ahmeti ka falënderuar të gjithë përfaqësuesit institucionalë, organizatat partnere vendore dhe ndërkombëtare, Policinë e Kosovës, FSK-në, KFOR-in, Bashkësinë Islame në Lipjan, bizneset dhe, mbi të gjitha, qytetarët e Lipjanit, të cilët, siç theksoi ai, kanë qenë partnerët tanë kryesorë në këtë rrugëtim. Së bashku, kemi ndërtuar një bazë të fortë për të vazhduar zhvillimin dhe mirëqenien e komunës sonë.

“Për herë të parë në historinë e Lipjanit, kemi arritur një sukses të jashtëzakonshëm, me shpenzimin e buxhetit komunal prej 97.8%, që rrallë ndonjë komunë ose institucion arrin të shpenzojë buxhetin në këtë masë, si dhe tejkalimin e të hyrave vetanake me 131%. Ky rezultat është dëshmi e angazhimit të përbashkët të qytetarëve, institucioneve dhe partnerëve tanë, duke bërë që Lipjani të shndërrohet në një shembull për të gjithë Kosovën”, tha Kryetari Ahmeti.

Ai theksoi gjithashtu se viti 2024 ka qenë një vit i jashtëzakonshëm për Komunën e Lipjanit, një vit ku, përveç investimeve në infrastrukturë, kemi arritur të përkrahim klubet sportive, organizatat e shoqërisë civile, fermerët dhe sektorin e bujqësisë, duke subvencionuar mekanizmat bujqësorë dhe asete të tjera të rëndësishme.

Kryetari Ahmeti, gjatë këtij organizimi, ka uruar të gjithë qytetarët për festat e fundvitit dhe i ka ftuar ata të vazhdojnë të kontribuojnë në zhvillimin e qytetit dhe vendbanimeve tona, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit të vazhdueshëm.



Komuna e Lipjanit

# Komuna e Lipjanit përfituese e Grantit të Performancës.

## 1,041,380.61 euro

Falënderimet për grupin e donatorëve: Bashkimin Evropian , Agjencinë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim , Ambasadën e Suedisë , si dhe për Ministrinë e Administratës së Pushtetit Lokal për mbështetjen e tyre të vazhdueshme.

### **Komuna e Lipjanit përfituese Grantit të Performancës**

*Me shumë kënaqësi ju njoftoj se kemi marrë konfirmimin që komuna jonë është përfituese në garën e performancës. Përfitimi i grantit prej 1,041,380.61 euro është një arritje e jashtëzakonshme dhe një dëshmi e qartë e menaxhimit të mirë, transparencës dhe llogaridhënies që po zbatojmë në komunën tonë.*

*Falënderimet më të sinqerta shkojnë për grupin e donatorëve: Bashkimin Evropian, Agjencinë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, Ambasadën e Suedisë, si dhe për Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal për mbështetjen e tyre të vazhdueshme.*

*Një falënderim i veçantë dhe i merituar shkon për shërbyesit civilë dhe grupin punues për performancë, të cilët, me përkushtimin dhe profesionalizmin e tyre, kanë qenë pjesë kyçe e këtij suksesi.*

*Urime të gjithëve! Ky është një tjetër shembull se, kur punojmë së bashku dhe me përkushtim, arrijmë të sjellim ndryshime pozitive për qytetarët e komunës sonë. Për Lipjanin tonë!*



### ***Një tjetër arritje për komunën tonë!***

***Komuna e Lipjanit është përfituese e renovimit eficient të shkollës “Shtjefën Gjeçovi” në Janjevë, në kuadër të Fondit për Eficiencë të Republikës së Kosovës.***

***Shuma prej 353,792.75 euro është siguruar nga ky fond, ndërsa komuna jonë, në bazë të marrëveshjes, zotohet për kthimin e mjeteve për një periudhë 15-vjeçare nga buxheti i saj.***

***Renovimi i kësaj shkolle do të transformojë kushtet për nxënësit dhe stafin arsimor, duke siguruar një ambient modern dhe të denjë për mësim.***

***Kjo arritje është dëshmi e përkushtimit tonë për të investuar në arsim dhe për të përmirësuar jetesën e qytetarëve tanë!***

***Urime!***



***Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, ka mbajtur mbledhjen e fundit konsultative me bordin e drejtorëve për vitin 2024***

*Gjatë këtij takimi, u diskutua mbi arritjet dhe sfidat që kanë shoqëruar gjithë këtë vit, si dhe përgatitjet për përmbushjen e objektivave të vitit të ardhshëm.*

*Kryetari Ahmeti falënderoi stafin dhe bordin e drejtorëve për angazhimin dhe përkushtimin e tyre gjatë vitit 2024, duke theksuar se rezultatet e arritura janë fryt i punës së palodhur dhe bashkëpunimit ndërsektorial. Ai gjithashtu ndau pikat kryesore të planeve për vitin e ardhshëm, duke vënë theks të veçantë te projektet që synojnë përmirësimin e jetës së qytetarëve të Lipjanit.*

*Në përfundim të kësaj mbledhjeje, kryetari z. Imri Ahmeti, së bashku me bashkëpunëtorët e tij, uruan të gjithë qytetarët e Komunës së Lipjanit për festën e Vitit të Ri, duke shprehur urimet më të mira që viti 2025 të jetë një vit i suksesshëm, me shëndet dhe harmoni në të gjitha familjet në Komunën e Lipjanit.*



***Të dashur qytetarë,***


***Me rastin e ndërrimit të viteve, ju falënderoj për përkushtimin dhe bashkëpunimin tuaj në çdo hap të angazhimeve tona të përbashkëta. Ky vit ka qenë plot sfida, por besimi dhe përpjekjet tona të palodhshme për të ndërtuar një të ardhme më të mirë kanë sjellë suksese të dukshme.***

***Viti 2025 nuk duhet të jetë thjeshtë një kapitull i radhës. Ky duhet të jetë viti i kthesës së madhe, momenti kur të gjithë, së bashku, të bëjmë ndryshimin që qytetarët tanë, me të drejtë, e presin dhe e meritojnë.***

***Le ta mirëpresim Vitin e Ri me shpresë dhe besim për një të ardhme më të ndritur. Ju uroj shëndet, harmoni dhe suksese për ju dhe familjet tuaja. Urime Vitin e Ri 2025!***

***Së bashku për një të ardhme më të mirë!  
Me respekt dhe mirënjohje,  
Imri Ahmeti***

# Komuna e Lipjanit - Zyra për informim



0 800 14 000 / 038 200 41 508



[infokomuna.lipjan@rks-gov.net](mailto:infokomuna.lipjan@rks-gov.net)



Rr. Shqipëria nr: 28 14000 Lipjan, Kosovë